
 Republika e Kosovës Republika Kosovo	<b>ZYRA E PERSONELIT          KANCELARIJA OSOBLJA</b>		 Komuna e Istogut Opština Istok
	02 Nr.101 /19	Datë: 17.05.2019	

Në mbështetje të nenit 13 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 12, paragrafi 4, të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe nenit 18 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Komuna e Istogut shpall :

### KONKURS

#### Për kryerjen e punëve me marrëveshje për shërbime të veçanta

**Drejtoria:** Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim

**Vendi i punës :** Zjarrfikës

**Nr. i referencës:** 02Nr.101 /19

**Lloji i pozitës:** Marrëveshje për Shërbime të Veçanta -kohëzgjatja 6 muaj

**Numri i ekzekutuesve:** 2( dyë )

**Orari i plotë:** 40 orë në javë

**Paga:** 400 €

#### Detyrat dhe Përgjegjësit:

1. Merr pjesë në intervenimet për fikjen e zjarrit dhe intervenime të tjera;
2. Kujdeset për pajisje dhe mjetet e përdorura gjatë intervenimit;
3. Kujdeset për ruajtjen e pasurisë gjatë intervenimit, kur nuk është pronari i pranishëm;
4. Rregullisht vijon trajnimet (ushtrimet e caktuara);
5. Kujdeset për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e pajisjes dhe mjeteve kolektive dhe personale;
6. Kryen dhe respekton të gjitha urdhëresat e udhëheqësit të ndërrimit, komandantit ose zëvendësit, përveç atyre urdhëresave të cilat do të ishin vepër kundërvajtës ose penale;
7. Si dhe shërbime të tjera që rrjedhin nga natyra e sigurisë së përgjithshme të paraqitura nga mbikëqyrësi.

#### Kualifikimet dhe shkathtësitë e kërkuara:

- Përgatitja e mesme shkollore;
- Përparësi do të kenë personat që kanë përvojë pune si zjarrfikës;
- Të ketë aftësi psiko-fizike për të kryer aktivitetet e zjarrfikës;
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Internetit).

**Dokumentet:**

- Dëshmi të kualifikimi shkollor: diploma e shkollës së mesme
- Dëshmi mbi përvojën e punës
- Dy rekomandime;
- Certifikata e trajnimit bazik për zjarrëfikës
- Dokument identifikimi;
- Certifikata e lindjes apo ekstrakti;
- Certifikata që nuk jeni nën hetime;

**Afati i Konkurimit:** Konkursi është i hapur tetë (8) ditë kalendarike nga data e publikimit.

Data e shpalljes së konkursit: 17.05.2019 deri më 24.05.2019

**Dokumentet e kërkuara :** Diploma mbi kualifikimin, dokumenti i identifikimit, ekstrakti i lindjes, dy rekomandime dhe dëshmi që nuk është nën hetime .

**Paraqitja e kërkesave :** Aplikacionet merren në Qendrën për Shërbim me Qytetar, kati i I-rë, Zyra nr.100 dhe kërkesat e plotësuara dorëzohen personalisht në të njëjtën zyre.

*“Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë “*

*“Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës “*

- Kërkesat e dërguara pas datës së fundit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen



Menaxheri i Peronelit  
Fatmir Bytyçi